



Raport vjetor 2017

QENDRA RINORE “ARDHMËRIA– KLINË”

KOSOVË

1 Janar & 31 Dhjetor 2017

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2017

KLINË



Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë zhvilluar programet dhe iniciativat rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara në Qender Rinore Ardhmeria-Klinë gjatë vitit kalendarik 2017.

Aktivitetet e qendrës rinore Ardhmeria-Klinë të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. KURSET E PËRDITSHME

2. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

3. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

4. STATISTIKAT / PËRFITUESIT

1. KURSET E PËRDITSHME:

1.1 **Kursi Gjuhës Angleze** në menyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i gjuhës Angleze për fëmijë dhe të rinjë. Çdo ditë gjatë vitit këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e Gjuhës Angleze. Kurset e gjuhës Angleze gjatë vitit 2017 janë udhëhequr 5 muaj nga vullnetarja evropiane (EVS) ndersa 3 mujorin e fundit është zhvilluar nga dy vullnetaret Lokale të Klinës. Kursi i Gjuhës Angleze është zhvilluar 2 orë ne javë për secilin grup (4 grupe) dhe ka zgjatur 3 muaj një nivel.



1.2 **Kursi Gjuhës frënge** është realizuar 6 muaj, dhe nga ky aktivitet përfituan 3 grupe të të rinjve, të cilët paten mundësi të mësojnë gjuhën frënge nga vullnetarja Belge (EVS), e cila me shumë përkushtim punoi dhe dha kontributin e saj tek rinia e Klinës.

1.3 **Grupi Teatrit:** është zhvilluar dy orë në javë , një grup i fëmijëve ushtruan 5 muaj teknikat e shfaqjes së teatrit dhe gjatë këtyre muajve arriten që ky grup të performoj dy shfaqje teatrale.

1.4 **Workshpet me fëmijë** Gjatë gjithë javës janë zhvilluar puntori të rregullta kreative për fëmijë dhe kemi krijuar një ambient të sigurtë që ata mund të punojnë gjëra të ndryshme nga letrat e përdorura, qeset e plastikes etj. Në mënyrë që fëmijët të edukohen për të mbrojtur ambientin dhe për të kaluar një pjesë të tyre të edukimit në qender rinore. Qëllimi i krijimit të kësaj puntorie dhe ndarja e kohës së veçant për fëmijë është edukimi për mbrojtjen e ambientit dhe reciklimin e mbeturinave nga vetë fëmijët. Kjo Puntori është zhvilluar nga stafi i qendres.

1.5 **Kursi gjuhës shqipe** Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë siguron edhe kursin e gjuhës shqipe për të rinjtë evropian që jetojnë në Klinë për një periudhë të gjatë dhe dëshirojnë të mësojnë shqip. Gjatë këtij viti një vullnetar lokal ka mësuar gjuhën shqipe 2 vullnetareve evropiane EVS nga Lituania dhe EVS nga Belgjika). Zhvillimi këtij kursi ka për qëllim integrimin e të rinjve që vijnë dhe jetojnë në Klinë për një periudhë kohore dhe gjuha shqipe ju mundëson që të adaptohen me lehtë në kulturen tonë kosovare.

2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

2.1 Pavarësia e Kosovës:

Për nëntë vjetorin e pavarësisë së Kosovës të rinjtë festuan ditën e pavarësisë me një grup të madh të të rinjve, dhe arriten gjatë ditës së 17 shkurtit në Klinë të krijojnë një ambient të mirë për të mësuar për shtetin e Kosovës dhe vlerat e saj.

Gjatë kësaj dite u zhvilluan dy aktivitete:

1. Shfaqja e dokumentarit për historinë dhe pavarësinë e Kosovës
2. Ngjyrosja e murit- flamuri i Kosovës

Në këto aktivitete moren pjesë rreth 50 të rinjë të moshës 14-20 vjeç, ku me vëmendje përcjellen dokumentarin historik të Kosovës dhe me shumë dashuri vizatuan dhe ngjyrosën flamurin e Kosovës në mur. Gjatë ngjyrosjes së flamurit disa të rinjë shoqëruan grupin rinor me këngë dhe kitare dhe kaluan disa orë argëtimi në qender rinore "Ardhmeria-Klinë". Ky ishte një aktivitet edukativo-shoqëror për rininë e Klinës.



Realizuar me 17 shkurt 2017 në Klinë

2.2 Festa e 8-të Marsit, dita botërore e gruas.

Për nder të festës së 8-të Marsit ditës së gruas, grupi Rinor "Klina Youth Chapter" organizoi aktivitetin e shpërndarjes së luleve.

Të rinjtë e grupit filluan aktivitetin e shpërndarjes së luleve tek gratë të cilat kanë punuar dhe ende punojnë në fuqizimin e gruas në shoqëri në Komunën e Klinës. Fillimisht grupi arriti t'i blej disa lule me fondet vetanake të grupit rinor dhe me 8-të Mars 2017 u shpërndan lule dhe nderuan disa prej këtyre grave që grupi rinor mendon se ato janë gratë më të suksesshme në Klinë. Aktiviteti filloi në ora 12:00 dhe përfundoi në ora 14:30. Pesëmbëdhjetë vullnetar të rinjë të grupit Klina Youth Chapter moren iniciative për të dërguar lulet tek vendet ku këto gra punojnë dhe veprojnë.



Rezultati: Gratë ishin shumë të befasuara dhe të lumtura nga iniciativa jonë, ato u ndjen të rëndësishme dhe premtuan se do të vazhdojnë të punojnë edhe më shumë për ngritjen e gruas në shoqëri dhe sidomos në zhvillimin e gruas kosovare përkatësisht asaj Klinase.

Grupi rinor "Klina Youth Chapter" falenderon të gjithë kontribuesit dhe përkrahësit e këtij aktiviteti dhe sidomos qendren rinore e cila vazhdimisht punon në zhvillimin e Rinisë.

Realizuar me 8 Mars 2017 në Klinë.

2.3 Prezantim për informim të të rinjve për bursat ndërkombëtare

Pasi që një ndër objektivat e Qendres është zhvillimi i rinisë dhe kohë pas kohe shperndajm informata për edukim , por gjithashtu edhe për mundësit e përfitimit të bursave ndërkombëtare. Ka më shumë se dy vite që bashkëpunojm me American school of Kosova që vin në Qender Rinore dhe prezantojn dhe informojn të rinjtë për procesin e aplikimit në universitet Amerikane. Në këtë ligjeratë moren pjesë një grup të rinjesh që janë të interesuar për të marr informatat e duhura por gjithashtu edhe për të marrur broshura që janë udhëzues i mirë për të rinjtë që nuk marrin pjesë.



Zhvilluar me 24 shkurt 2017, në Klinë.

2.4 Film dokumentar

Për të inicuar Workshopet kreative dhe ato edukative në botën e mjedisit, stafi i Qendres shfaqti një film dokumentar që ka karakter vetdijësues tek të rinjtë. Pas shfaqjes së dokumentarit të rinjtë patën mundësi të shkruajn për mundësit e mbrojtjes së ambientit dhe se c'farë mund të bëjm ne si shoqëri e re për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit.



Zhvilluar me 28 Shkurt 2017, në Klinë

2.5 Dita e Ujit

Me 22 mars të rinjtë e Klinës shënuan ditën ndërkombëtare të ujit dhe gjatë kësaj dite u organizuan disa aktivitete për të vetëdijësuar të rinjtë e Klinës për rëndësinë e ujit.

Workshopi është zhvilluar në hapsiren e qendres rinore ku moren pjesë fëmijët e moshës 7-10 vjeç, Lehtësues të këtij workshopi ishin dy vullnetare të cilat kishin përgaditur një ligjeratë për fëmijë për të treguar rëndësinë e ujit dhe gjithashtu zhvilluan disa lojra kreative për të mësuar fëmijët për rëndësinë e ujit.

Ligjeratë për të rinjtë: në këtë ligjeratë vetëdijësuese moren pjesë të rinjtë e moshës 12-15 vjeç të cilët vijuan një ligjeratë dhe paten mundësi të shohin një film dokumentar për vetëdijësimin e kursimit të ujit në shoqëri.

Rëndësia e ujit : dy vullnetar kreative shprehen dëshirën që një grupi rinor të ju japin shëmbuj praktik për rëndësinë e ujit. Organizuan që të gjithë të rinjtë të shkojnë së bashku në natyrë afër lumit, për të demonstruar një shëmbull praktik për të mësuar që në rast të ndonjë situatë kur mbesim pa ujë dhe jemi në natyrë të vetem se si mund të përdorim një metodë për të krijuar pika të ujit për të mbijetuar situatën.



Zhvilluar me 22 Mars, Klinë

2.6 Dita Botërore e Tokës/Global youth Service day

Për të shënuar ditën botërore të Tokës dhe për të vetëdijësuar qytetarët tonë të Klinës grupi rinor nga Qendra Rinore "Ardhmeria-Klinë" organizoi aktivitete dy ditë, në mënyrë që të sensibilizoj të rinjtë për realitetin e natyrës në Klinë.

Grupi rinor filloi aktivitetin e parë duke kontaktuar më shkollën fillore "Ismet Raci" në Klinë dhe moren leje për të zhvilluar dy ditë aktivitete në oborr të shkollës së bashku me nxënësit e po asaj shkolle.

Ditën e parë një numër i të rinjve mbledhen mbeturinat e oborrit të shkollës pastruan të gjitha mbeturinat të cilat ishin mbrenda oborrit.

Ditën e dytë në një ambient të paster që ishte krijuar një ditë më parë, të rinjtë organizuan një event kulturor ku shumë të rinjë kaluan disa orë vizatimi të natyrës në oborr të shkollës, dhe në pikturat e tyre shfaqen natyrën dhe peizazhin e bukur që të rinjtë duan ta kenë në të ardhmen.



Qëllimi i iniciatивes ishte që të rinjtë të japin një mesazh sensibilizues tek të rinjtë për mbrojtjen e ambientit dhe të vlerësojmë pasurinë e natyrës që kemi në oborret tona.

Ipmlmentuar nga Grupi Rinor- Klina Youth Chapter, 22 Prill 2016.

Trajnim për të rinjë –Debat sipas modelit British Parliamentary

Në Qender Rinore u mundësua Trajnimi 5 ditor për të rinjtë e moshës 15-24 vjeç. Trajnimi është organizuar në kuader të projektit të ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mënyrë që të krijojmë mundësitë për të rinjtë e Qendrave Rinore të zhvillojnë aftësitë e tyre argumentuese, retorikën dhe mendimin kritik si parakusht për pjesëmarrjen e tyre në proceset socio-politike dhe vendimmarrëse sipas modelit British Parliamentary.

Grupi rinor prej 16 të rinjve në Qendren Rinore Ardhmeria-Klinë është trajnuar 5 ditë dhe është realizuar shumë mire pasi që të gjithë të rinjtë ishin të interseuar dhe shumë aktiv. Trajnimi 5 ditor është udhëhequr nga trajneri profesional i debateve rinore dhe i organizuar nga stafi i Qendres rinore.

Gjatë trajnimit janë organizuar mini debate me tema të ndryshme për pjesëmarrësit ku të gjithë kanë mesuar teknikat e debateve dhe metodat edukuese të debatit.



Zhvilluar prej 7-11 Maj 2017

2.5 Konferencë për Lider të rinjë MCW në Pejë,

Ekipi i MCW (Miracle corner of the World) nga SHBA së bashku me stafin nga Qendra Rinore ARDHMERIA dhe #MCWYLP Alum nga Kosova ndihmuan në përgatitjen dhe organizimin për konferencën rinore .

Konferenca e Liderëve të Rinjë u përqendrua në çështjet relevante si papunësia e të rinjëve, gjinia dhe arsimi zhvillim të aftësive për krijimin e një plani vizionesh. Liderë të rinjë nga e gjithë Evropa dhe Lindja e Mesme mbërritën në Pejë, Kosovë për konferencën e parë të Liderve të rinjë të MCW që është zhvilluar gjatë tre ditëve në Pejë.

Dita e parë Pjesëmarrës të rinjë nga Evropa dhe Lindja e Mesme morën pjesë në punëtori dhe sesione, duke përfshirë: çfarë do të thotë të jetë një "udhëheqës (Lider), vizioni dhe planifikim i misionit, rëndësia e të qenit krijues, bingo në rrjet, kuptimi i qëllimit të katit të ashensorit dhe këshilla për marrjen e një pune të paraqitur nga PWC(Pricewaterhouse eCoopers) Kosova. Pas një dite të mbushur me punë, grupi I të rinjve ndërkombëtar vizituan Burimin e Drinit të bardhë dhe shpellën afër Drinit për të përjetuar bukurinë dhe natyrën e Kosovës.



Dita dytë e Konferencës së Liderëve të Rinjë në Pejë në Kosovë u përqëndrua në atë se çka do të thotë të jesh një qytetar botëror, barazinë gjinore përmes një hyrjeje në HeForShe-Jordan, duke përcaktuar çështjen tuaj përmes një "pse pse?" stërvitje, dhe një seminar nga rrjeti mijëvjeçar Global mbi rëndësinë dhe ndikimin e politikave për të rinjtë.



Dita tretë e Konferencës sonë të Liderëve të Rinjë në #Peja, #Kosovo dhe pjesëmarrësit kanë punuar përmes sfidave dhe strategjive me ndihmën e Drejtorit Ekzekutiv të MCW, Jacinda. Ekipi ynë frymëzohet nga lideret e rinjë që kanë pasion për të ndihmuar komunitetet e tyre në të gjithë Evropën dhe Lindjen e Mesme. Konferenca e Liderëve tanë të Rinjë në Pejë, Kosovë, ndihmoi pjesëmarrësit me prekje përfundimtare të planeve të tyre vizionare. Liderët e rinjë nga Evropa dhe Lindja e Mesme kaluan nëpër çdo pjesë të procesit të planifikimit - nga misioni dhe vizioni në strategji, në burime, pengesa, palët e interesit dhe afatet kohore. Deri në fund të ditës dhe me aftësitë dhe teknikat e fituara gjatë tri ditëve të fundit, çdo lider i Ri praktikonte dhe paraqiste me sukses prezantimet tek Drejtori Ekzekutiv i MCW. Konferenca në Kosovë ofroi mjete dhe aftësi për të planifikuar projekte për komunitetet e tyre. Ne u përqendruam në barazinë gjinore, papunësinë e të rinjve dhe arsimin në rajonet #Balkan dhe #Lindje të mesme. Liderët e rinjë nga Evropa dhe Lindja e Mesme kanë qënë aktiv gjatë tri ditëve - duke ndarë përvojat personale nga komunitetet e tyre



Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë është kaq krenare që të mirëpresë dhe të jëtë partnere lokale për konferencën e liderve të rinjë të MCW në Kosovë dhe të jetë pjesë e familjës MCW.

Zhvilluar në Kosovë, me 27-30 prill 2017

2.6 Promovimi i programit EVS- vullnetar evropian

Ne si Qender Rinore jemi akredituar ne Salto SEE që nga viti 2009 për të mirëpritur dhe derguar vullnetar në Evropë në periudhe të gjatë prej 6 deri 12 muaj. Iniciativa për të promovuar këtë program për ditën e Evropës është organizuar nga të rinjtë Kosovar dhe të rinjtë Evropian (EVS). Pasi që në Qender rinore vin çdo vit 1 apo 2 vullnetar nga Evropa dhe punojnë në zhvillimin e rinisë tonë, atëherë



edhe ne duhet të promovojmë këtë program që të rinjtë e Klinës të përfitojnë nga programi.

Prezantimi dhe promovimi është zhvilluar në shkollën profesionale "Fehmi Agani", ku më së shpejti një numër i madh të të rinjve, të rinjtë paten mundësi që të shkembejnë informata dhe të marrin njohuri për vendet evropiane dhe intergrimin evropian, dhe proceset e programit të EVS.

Prezantimi është mundësuar nga EVS-Cathy Lambert, Belgjika & EVS-Rūta Ruzgytė, Lituania.

Zhvilluar me 25 Maj 2017

2.7 Debat për të rinjë

Pasi që ishim përfitues të një trajnimit për udhëheqje të debateve sipas British Parliamentary në Klinë realizuam edhe Dabatin e quajtur "Sallonet" në formë Debatit për të rinjë, i cili është përkrahur nga projekti i përbashkët i institutit D4D dhe FES në partneritet me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjithashtu në bashkëpunim me qendrat rinore të Kosovës.

Në Klinë diskutuam temën:

"A është rinia kosovare përkrahëse dhe lobuese e barazisë gjinore?" . Debatit është udhëhequr nga panelistët të rinjë që kanë përvojë në karrierën e tyre si lider të një institucioni apo një grupi të përcaktuar ku vlerësohet puna dhe kapaciteti i tyre si individë e jo si gjini. Ky diskutim i përbashkët në mes të panelit dhe të rinjve (mosha 15-24 vjeç) dhanë një motivim për të rinjtë e Klinës që të përkrahin dhe të llojnë për barazinë gjinore në të ardhmen.

Qendra Rinore falënderon të rinjtë pjesëmarrës dhe panelistët për këtë bashkëpunim:

1. Vlora Tafili-Asambliste e komunës së Klinës.
2. Elbasan Raci-Përfaqësues i OJQ-KOHA.
3. Heloia Elezaj-Anëtare e Q.R Ardhmëria-Klinë

Zhvilluar me 26 Maj 2017, në Klinë

2.8 1 Qershori-Festa e fëmijëve

Festa e fëmijëve në Klinë është organizuar me iniciativën e Qendres Rinore Ardhmëria-Klinë, dhe është përkrahur nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport të Komunes së Klinës, duke arritur bashkëpunim të mirefilltë që festa e fëmijëve 1 Qershori të mbahet në Shtëpinë e Kulturës "Jehona Dukagjinit".

Programi i organizuar përfshiu një numër të konsiderueshëm të shkollave fillore të komunës Klinës me një numër të madhë të fëmijëve të cilët më së shpejti në programin festiv të 1 Qeshorit duke e bërë shumë madhështore dhe atmosferë festive në mbarë qytetin e Klinës. Gjatë ditës festive të 1 Qeshorit

të gjithë fëmijët u argetuan, kënduan dhe duarktrokiten së bashku. Programi përfundoi me një shfaqje teatri dhe argetimi të përbashket nga MASKOTAT E MIKIMAUS.



Bashkëpunor: Vullnetarët e Qendres Rinore, Shkollat fillore dhe MASKOTAT për fëmijë.

Zhvilluar me 1 qershor 2017, në Klinë

2.9 Programi Veror 2017

Gjatë muajit Korrik qendra rinore ka organizuar një program veror për fëmijë dhe të rinjë në mënyrë që të zhvillojm kapacitetet dhe aftësit e te rinjve në aktivitete dhe në komunitet. Qëllimi i këtij programi është që të motivojm të rinjtë të punojn me fëmijë dhe njëkohësisht të zhvillojn aftësit dhe kapacitet rinore në organizim, menaxhim dhe lidership.



Programi veror është zhvilluar gjatë muajit korrik dhe ka zgjatur 21 ditë, gjatë këtyre ditëve të ngrohta korriku çdo ditë kemi ofruar ëorkshope për fëmijë, lojra edukative dhe argetuese, ushtrime teatrale, Animacion dhe gjithashtu një ditë në javë është dedikuar për të rinjë ku kanë organizuar Shfaqje të filimit dhe Debat rinor.



Pr
og

ramin veror e kemi përfunduar një shfaqje teatrale "Puppets shadoë theater" në shtëpi të Kulturës "Jehona Dugagjinit" në Klinë.



Zhvilluar prej 3 korrik -21 Korrik 2017, në Klinë.

2.10 Ngjarje Kulturore" Halloween n'Klinë"

Eventi Halloween n'Klinë është organizuar nga Qendra Rinore Ardhmëria-Klinë dhe grupi rinor Klina Youth Chapter gjithashtu në bashkëpunim me Caritas Umbria dhe Kloun family nga Italia. Gjatë mbrëmjes Halloëeen janë zhvilluar disa lojëra argetuese me shperblime, vizatime të fytyrave dhe shfaqje nga Kloun family.



Në event moren pjesë shumë fëmijë dhe qytetar të komunës së Klinës dhe fshatrave të saj ku edhe ne si qender rinore arritem qëllimin tonë duke pasur një numër të madh të qytetarëve në këtë event dhe shumë fytyra të gëzuara të fëmijëve.

Eventi Halloween është përkrahur nga Drejtoria e Kultures, Rinisë dhe Sportit me muzik dhe është sponsorizuar nga disa biznese të qytetit dhe nga zonja Judy Thompson Childers nga SHBA.

Qendra Rinore Ardhmeria-Klinë Falenderon të gjithë bashkëpunoret dhe në veqanti të rinjtë dhe vullnetaret tonë për një përkushtim në programet rinore në Klinë.

Zhvilluar me 31 tetor 2017, në Klinë.



2.11 20 Nëntori

Për të shënuar 20 Nëntorin të rinjtë e qendres realizuan një event edukativ dhe shfaqen filmin "My sister's keeper" dhe fëmijët paten mundësi të shohin se c'farë janë të drejtat e fëmijëve dhe sa respektohen ato, gjithashtu në përfundim fëmijët përshkruan se sa në jetën reale praktikohen të drejtat në familje dhe shoqëri. Është krijuar një ambient i mirë dhe i dashur për të rinjtë ku secili ndihet mirë dhe ndihet i respektuar nga tjetri.

Ërkshor i zhvilluar me 20 Nëntor, në Klinë.



2.12 Dita botërore e HIV/AIDS



Punuar me 1 Dhjetor 2017, Klinë.

Në ditën botërore të HIV/AIDS kemi përgaditur broshura dhe kemi shpërndarë shumë broshura në qytet dhe shkolla, në menyrë që të vetdijësojmë komunitetin tonë dhe të jemi përkrahës të ditës botërore, gjithashtu grupi rinor ka organizuar një fushatë vetdijësuese për rrjetet sociale dhe është publikuar në youtube

<https://www.youtube.com/watch?v=Czqj1Yy4q-Y>.

2.13 Fushatë për të drejtat e njeriut

Pasi që jemi bashkëpunor dhe antar të disa rrjeteve rinore evropiane gjithashtu marrim pjesë në fushatat vetdijësuese për të drejtat e njeriut, dhe kësaj radhe përgaditem një video për rrjetet sociale dhe ishim pjesë e fushatës botërore në si Rini e Klinës.

<https://www.youtube.com/watch?v=7zKsiMPx988>

Punuar me 8 Dhjetor 2017, Klinë.

2.14 Aktivitetet Humanitare

Gjatë muajit dhjetor 2017 vullnetarët e Qendrës Rinore organizuan shumë aktivitete për të mbledhur fonde për familjet në nevojë. Aktivitetet që u realizuan janë:

Mbledhja e parave në biznese private, ku gjatë 4 ditëve dy grupe të të rinjve vizituan secilin biznes në Klinë për të mbledhur fonde për bamirësi.

Shitja e embëlsirave në qytet- 15 vullnetar kanë angazhuar familjët e tyre dhe me përkushtim vetank kanë gatuar ëmbëlsira dhe gjëra tjera ushqimore në mënyrë që t'i shesin ato për të krijuar fonde dhe me 13 dhjetor të gjitha ëmbëlsirat janë shitur në qytet.

Shitja e kartolinave- një grup i të rinjve kanë punuar 5 ëorkshope për të punuar kartolina kreative të cilat janë shitur në shesh të qytetit nga vet të rinjtë.



Shfaqje të filmit- dy të



rinjë kane organizuar tri ditë që të shfaqin 6 filma, ku 3 prej tyre ishin për fëmijë dhe 3 të tjerë që u shfaqen në mbrëmje ishin Filma për të rinjë që kishin karakter bamirësie. Një numër i madh i të rinjve moren pjesë dhe kjo u verjet se mungon Kino në Klinë.



Me shumë përkushtim dhe me një përkrahje të madhe nga qytetaret e Klinës dhe bizneset e Klinës vullnetarët arriten të sigurojnë fondet dhe të përgadisnin dhurata për 8 familje të Komunës së Klinës.

Nga fondi i mbledhur të rinjtë përgaditen veshmbathje, ushqime dhe dhurata për fëmijë të cilat janë shpërndarë me 28 dhjetor 2017. Gjatë realizimit të të gjitha aktiviteteve është vërejtur një vullnet i qytetarëve dhe bizneseve të vogëla për të përkrahur aktivitetin humanitar të inicuar nga Rinia.



Aktiviteti humanitar është organizuar nga Qendra Rinore "Ardhmëria - Klinë", përkrahur nga KFORI Slloven(veshmbathje), Bizneset private dhe qytetarët e Klinës.

Zhvilluar prej 8 -28 dhjetor 2017, në Klinë.

2.15 Mbrëmje për Krishtlindje dhe Vitin e RI 2018

Për të përmbledhur dhe reflektuar të gjitha aktivitetet gjatë vitit Qender Rinore Ardhmëria-Klinë organizoi një mbrëmje për të gjithë antaret e saj dhe vullnetaret që ishin aktiv gjatë tërë vitit. Festuam së bashku dhe kujtuam aktivitetet e realizuara të vitit 2017 me një video që përmbledhi fotografit e tërë punës vjetore. Mbrëmja përmbyllese u percjell me lojra dhe muzik për të rinjë. Ceremonia u përmbyll me shpërndarje të Mirënjohjeve për antaret që ishin aktiv gjatë vitit 2017 si dhe me dhurata nga vet të rinjtë.



Gëzuar Viti ri 2018



3. BASHKËPUNIME DHE PARTNERËT

3.1 Ojq "Human",

Ojq HUMAN nga Peja ishte përfituese e projektit të Ambasades Amerikane, në kuader të këtij projekti për "Vetdijësim të Korrupsionit" Qendren Rinore ishte partner lokal për angazhimin e vullnetarëve në punën e terenit, roli i Qendres në këtë projekt ishte të shpërndajm broshura dhe intervistojm qytetaret në 18 fshatra të Komunës së Klinës.

Fushata për "Vetdijësim të Korrupsionit" në fshatrat e komunës së Klinës ka filluar në Janar dhe ka përfunduar në Qershor 2017.

3.2 Peace Corps -Vullnetare e komunitetit.

Këtë vit qendra rinore ishte përfituese e një partneriteti të ri me organizaten Amerikane Peace Corp, dhe në formë vullnetare kemi mirëpritur një vullnetare nga Texasi i Amerikës e cila është akomoduar në një familje Klinase. Vullnetarja 32 vjeqare ka punuar me stafin e qendres rinore në menaxhment në mënyrë që të ngrisim kapacitet e strukture së menaxhmentit në qender rinore. Në fund të vitit 2017 vullnetarja nga Peace Corp ka përfunduar missionin e saj në Klinë.

3.3 Association des Compagnons Bâtisseurs asbl nga Belgjika-EVS

Projekti EVS "Be the change of tomorrow" me kodin 2016-3-BE04-KA105-001972 i financuar nga Agency of International Youth Co-operation është implementuar në Klinë duke filluar prej 3 shkurt -30 Korrik 2017. Ky projekt ka mundësuar që Vullnetarja Cathy Lambert nga Belgjika të vij dhe të punoj në Qender rinore për 6 muaj në Klinë. Në Qender rinore ajo ka zhvilluar shumë aktivitet për fëmijë dhe të rinjë dhe njëkohësisht ka zhvilluar personalitetin e saj në njohjen e kultures dhe traditave tona Kosovare.

3.4 Organizata Actio Catholica Patria (2013-LT-35) nga Lituania-EVS

Projekti EVS "SUGAR AND SPICE OF EVS " me kodin 2016-3-LT02-KA105-004977 i financuar nga Agency of International Youth Co-operation është implementuar në Klinë. Projekti ka filluar prej 1 shkurt deri me 31 Korrik 2017. Projekti evropian ka mundësuar që Vullnetarja nga Lituania të vij dhe të punoj në Qender rinore për 6 muaj në Klinë. Në Qender rinore ajo ka zhvilluar Kursin e Gjuhës angleze për fëmijë dhe njëkohësisht ka zhvilluar personalitetin e saj në njohjen e kultures dhe traditave tona Kosovare.

1. STATISTIKAT / PËRFITUESIT

TABELA 1: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Etnicitetit

Perioda	Shqiptar	Serb	RAE	Tjera	Total
01/1/2017-30/12/2017	196	0	0	2	198
%	98.99	0.00	0.00	1.01	100.00




TABELA 2: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Origjines

Perioda	Rural	Urban	Total
1/1/2017-31/12/2017	58	140	198
%	28.93	71.07	100.00




TABLE 3: PËRFITUESIT NË BAZË TË MOSHES						
Perioda	<15	15-18	19-21	22-24	>24	Total
1/1/2017-31/12/17	113	78	2	4	1	198
%	57.07	39.39	1.01	2.02	0.51	100.00




TABLE 4: PËRFITUESIT NË BAZË TË GJINISË			
Perioda	Mashkull	Femer	Total
1/1/2017-31/12/17	71	127	198
%	35.53	64.47	100.00

